

KUSHTETUTA



LIGJ MBI LIGJET

SHOQËRIA DEMOKRATIKE

FJOLLA (12), AZDREN (12), KIFAJETE (12), DIELL (12), FLORIAN (12), FATLUM (12)



Barazia gjinore, si një element shumë i rëndësishëm në demokraci


Të dashur lexues, ne jemi disa nga nxënësit e klasës VII-2 nga shkolla „Halil Alidema“ nga Pozherani. Në këtë artikull kemi shkruajtur një përmbledhje të disa fakteve dhe mendimeve tona për demokracinë. Ju ftojmë ta lexoni

Në çdo shoqëri demokratike ka vlera dhe mënyra të ndryshme jetese. Liria e njeriut për të zgjedhur mënyrën e tij të jetesës është një aspekt i rëndësishëm i të drejtave të njeriut.

Demokracia do të thotë udhëheqje e popullit. Për herë të parë u shfaq në Athinë, në vitin 507 para erës sonë. Të drejtën e vendimmarrjes e kishin vetëm burrat e pasur me prejardhje athinase, kurse gratë dhe skllëverit nuk e kishin këtë të drejtë. Tani në kohën e sotme, në vendet demokratike të gjithë kanë të drejta të barabarta dhe i gjithë populli merr vendime.

Janë të njohura dy lloje të demokracisë, dhe ato janë: demokracia e drejtpërdrejtë dhe demokracia përfaqësuese. Në demokracinë e drejtpërdrejtë populli merr vendime aty për aty, kurse në demokracinë përfaqësuese, populli i zgjedh përfaqësuesit e tij me anë të votave. Kosova është një vend demokratik me sistem parlamentar, sepse populli në zgjedhje i voton deputetët si përfaqësues të tij. Por, ka vende të tjera demokratike me sistem presidencial, ku populli në zgjedhje e voton gjithashtu edhe Presidentin si përfaqësues të vendit.

Të drejtat e njeriut janë të shumta në demokraci. Për shembull, ne si fëmijë e kemi të drejtën e shkollimit, të drejtën e argëtimit, të drejtën e familjes, të drejtën e emrit, të drejtën e shoqërisë, etj. Prandaj, jemi të lumtur që jetojmë në një vend demokratik.



Edhe ne si fëmijë i kemi të drejtat tona



Grupi „Demosi“



Rregullat që duhet të zbatohen



Drejhtësia në demokraci

Ne jemi qytetarë të përgjegjshëm, sepse i respektojmë ligjet. Respektimi i ligjeve do të thotë se edhe ne mund të ndikojmë në zhvillimin e demokracisë


Ligjet janë rregulla që miratohen në Kuvend dhe që duhet t'i respektoj dhe t'i zbatoj çdo qytetar. Ne si fëmijë kosovarë, duhet të jemi të vendosur për të ndër-tuar një ardhmëri sa më të ndritur për Kosovën, si një vend i lirë dhe demokratik.

Të gjitha ligjet bazohen në Kushtetutë, e cila është ligj mbi ligjet. Kushtetuta e Republikës së Kosovës hyri në fuqi më 15 qershor 2008 dhe ajo përbëhet nga 162 nene. Sipas nenit 29 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, secilit qytetar i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë. Prandaj, ne jemi të lirë t'i shprehim dëshirat tona. Mirëpo, secili duhet të ketë respekt për dëshirat e njëri-tjetrit.

Respekti ndërtohet përmes diskutimit, mirëkuptimit të ndërsjelltë dhe vullnetit për të bashkëpunuar.



Të bashkuar shkojmë përpara




Jetojmë me elementet e demokracisë

DEMOKRACIA, KUVENDI DHE QYTETARËT

EDISONA (12), OLZA (12), TRIM (12), MELOS (12), ENSAR (12)

Qytetarë të dashur, ne duam mendimin tuaj për mënyrën se si mund ta forcojmë demokracinë. Për këtë ne fëmijët, kemi dalur në qytetin e Prishtinës dhe kemi pyetur disa prej jush. Nëse dëshironi të dini cilat ishin përgjigjet e qytetarëve, lexojeni këtë artikull

Fillimisht ne erdhëm në Punëtorinë e Demokracisë dhe në rolin e gazetarëve mësuam për Kuvendin e Kosovës. Gjëja e parë që e mësuam ishte dallimi mes rregullave dhe ligjeve. Rregulla kemi ngado, si në shkollë, në shtëpi, apo në lojë. Por, ligjet janë rregulla që dalin nga Kuvendi, vlejné për të gjithë njësoj, si dhe ato duhet të zbatohen nga të gjithë. Kjo është një ndër detyrat e Kuvendit: miratimi i ligjeve. Por, a e dini se cila është detyra parësore e Kuvendit? Ajo është përfaqësimi i qytetarëve dhe interesave të tyre. Kuvendi ka edhe një detyrë të tretë, ajo është kontrollimi i Qeverisë. Ky institucion është „Shtëpia e Popullit“ në të cilin punojné 120 deputetë. Ata flasin në emrin e të gjithë neve.



Kjo është shtëpia jonë



Edona gjatë intervistës me ne



Qytetarët u ndalën dhe dhanë shumë përgjigje të mira

Pasi që folëm për Kuvendin, ne dolëm në rrugët e Prishtinës, ndalëm disa kalimtarë të rastit dhe ata na dhanë disa përgjigje. Valentina Agostini na tha se për ta forcuar demokracinë, qytetarët duhet t'i respektojnë ligjet. Kurse, Edona Miftari u shpreh se për ta arritur këtë gjë, qytetarët duhet të organizojné iniciativa dhe peticione për çështje të ndryshme që i brengosin ata. Ne po ashtu, morëm edhe një përgjigje nga një qytetare tjetër, e cila ishte Arta Berisha. Ajo na tha se duke qenë më shumë pjesëmarrës në zgjedhje dhe duke marrë iniciativa rinore, ne mund të ndërtojmë edhe më tej demokracinë. Nga këto përgjigje, ne mësuam shumë gjëra për demokracinë. Shpresojmë se edhe ju keni mësuar diçka të re për këtë temë.



Gazetarët e terrenit raportojné

VOTA NË DEMOKRACI

LINDRIT (12), AGRON (12), XHYZIDE (12), VALERIAN (12), ELMEDINA (13)


Demokracia nuk njih dallime, ajo i trajton të gjithë qytetarët në mënyrë të barabartë, pa dallim feje, gjinie, race, kombësie, etj. Baza e demokracisë është udhëheqja e popullit, për këtë zgjedhjet janë të domosdoshme në demokraci

Zgjedhjet janë forma më demokratike për marrjen e pushtetit. Këtë më së miri e kuptojmë nga zgjedhjet e fundit që janë zhvilluar në vendin tonë.


Ka pasur disa parti dhe kandidatë të ndryshëm të cilët kanë kandiduar, por fitues dolën të jenë ata të cilët arritën të fitojnë më së shumti vota. Këto zgjedhje janë të njohura si zgjedhjet qendrore. Ndërsa, në zgjedhjet lokale që do të mbahen këtë muaj, qytetarët po ashtu mbi moshën 18 vjeçare, do të votojnë për kryetarët e komunave dhe kandidatët për asamble komunale. Kur themi asamble komunale kemi parasysh që qytetarët nga komunat përkatëse, do t'i votojnë kandidatët për asamble të po asaj komune.



Ju, të dashur qytetarë që e keni të drejtën e votës, votoni, sepse ju e sjellni ndryshimin



Qytetarët mbi moshën 18 vjeçare kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin zgjedhor



Janë votat e qytetarëve, ato të cilat vendosin të ardhmen e vendit



Ne jemi të lumtur, vetëm atëherë kur jemi vetvetja

Te ky vizatimi këtu, shoku ynë Valeriani ka paraqitur një ylber të lumtur. Ne dëshirojmë t'iu tregojmë juve të dashur lexues, se të lumtur e të barabartë ishim edhe ne sot në këtë Punëtori. Secili nga ne ishte përgjegjës për një detyrë, sepse sipas nesh përgjegjësia është ajo që na rrit. Secili prej nesh ishte i lirë të zgjedhë atë që e mendonte se e zotëronte më së miri, ngase zgjedhja është e lirë dhe nuk duhet të imponohet. Për këtë, ne mendojmë që artikulli ynë është një artikull i mirë, sepse këtu çdo gjë është shkruar dhe vizatuar nga mendime të lira dhe me shumë bashkëpunim. Kjo është edhe vetë demokracia, një sistem ku të gjithë njerëzit janë të lumtur për atë që janë dhe bashkëpunojnë në mes vete.



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Halil Alidema“
Klasa: VII-2
Vendi: Pozheran, Viti